



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

Nr. 486/3 Prot.

Tiranë, më 10/6 /2015

VENDIM

“ Për rrëzimin e ankesës”

Nr. 38, datë 10/6 /2015

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, shkronjës a) të nenit 31/1 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale,

V Ë R E N:

Ankuesi/Qendra “Res Publica”, ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit ankesën Nr.486 Prot., datë 20.05.2015, ndaj Autoritetit Publik/ Drejtoria e Përgjithshme e Policisë me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie të informacionit”. Ankuesi/ Qendra “Res Publica” ka paraqitur pranë Autoritetit Publik/ Drejtoria e Përgjithshme e Policisë, kërkesën nr. 055/15Prot., datë 20.04.2015, me të cilën ka kërkuar ti vihen në dispozicion kopje të dokumenteve, konkretisht:

1. Sa është nr. i subjekteve të kontraktuara dhe vlera e objektit të secilës kontratë për prodhimin, transmetimin e spoteve publicitare, reklamave si dhe njoftimeve të botuara në shtypin e shkruar për periudhën 01.09.2013-01.03.2015.
2. Kopje të urdhrimit/ave të prokurimit, për prodhimin, transmetimin e spoteve televizive, reklamave si dhe njoftimeve të botuara në shtypin e shkruar.
3. Kopje të ftesës për negociata që i është bërë subjekteve dhe listën e mediave që i është dërguar ftesa.
4. Kopje të urdhrimit për ngritjen e Komisioneve për ndjekjen e procedurave për prodhimin, transmetimin dhe blerje të spoteve publicitare, nëse ky komision nuk është ngritur me Urdhrin e Prokurimit.
5. Cili është linku ku është publikuar ftesa për oferta.
6. Kopje të procesverbalit të vlerësimit me pikë të operatorëve pjesëmarrës.
7. Kopje të raportit të Komisionit mbi procedurën e ndjekur, drejtuar titullarit.
8. Kopje të vendimit të titullarit për lidhjen e kontratës(nëse ka).
9. Kopje të kontratës së lidhur për prodhimin dhe transmetimin e spoteve publicitare dhe njoftimeve/reklamave të botuara në shtypin e shkruar.

Ankuesi pretendon se është çenuar në të drejtën për informim, pasi nuk është informuar lidhur me sa ka kërkuar megjithëse ka kaluar afati ligjor. Për këtë arsye ka depozituar ankim në zyrën e Komisionerit.

Komisioneri, pas vlerësimit të ankesës, verifikimit të fakteve dhe bazës ligjore të saj, me urdhrin nr.125, datë 01/06/2015, urdhëroi kryerjen e inspektimit administrativ pranë Autoritetit Publik/ Drejtoria e Përgjithshme e Policisë.

Grupi i inspektimit konstatoi se në protokollin e Autoritetit Publik/ Drejtoria e Përgjithshme e Policisë rezultoi të jetë depozituar kërkesa e Qendrës "Res Publica". Gjatë inspektimit u konstatua se, ndryshe nga sa pretendon ankuesi/ Qendra "Res Publica", Autoritetit Publik/Drejtoria e Përgjithshme e Policisë ka informuar kërkuuesin duke i kthyer përgjigje brenda afatit ligjor me shkresën nr.2001/1Prot., datë 02.05.2015. Në këto kushte, lidhur me ankesën e Qendrës "Res Publica", ndaj Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë, Komisioneri vlerëson se, ankesa rezultoi e pa bazuar në ligj dhe si e tillë ajo duhet rrëzuar.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në shkronjën c) të pikës 5 të nenit 24 të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit",

V E N D O S A:

1. Rrëzimin tërësisht të ankesës nr. 486 Prot., datë 20.05.2015 të Qendra "Res Publica", kundër Autoritetit Publik/ Drejtoria e Përgjithshme e Policisë.
2. Kundër këtij vendimi ankuesi ka të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative kompetente, në përputhje me nenin 25 të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit".
3. Ky vendim u dha sot në datë 10.06.2015.

Besnik DERVISHI



KOMISIONERI